



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:163562

Datë: 09.03.2021

Numri i dokumentit: 01576824

C.nr.100/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA PODUJEVË, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtarin e vetëm gjykues Binak Duqi dhe zyrtaren ligjore Dalina Kërçeli, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli Prishtinë, kundër të paditurit E. B. nga fshati L. K. P. me objekt kontesti për rimbursim dëmi, vlera e kontestit 529.00 euro, jashtë seance, me datën 09.03.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Për shkak të padëgjueshmërisë / Mosbindjes /

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit-BKS me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri E. B. nga fshati L. K. P. t'ia rimbursoj shumën prej 529.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës ..., në P. me kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste të Kosovës, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

II. Refuzohen si të pa bazuara kërkesat e palës paditëse që kamata në shumën e aprovuar të llogaritet nga dita e ushtrimit të padisë në gjykate deri në pagesën definitive si dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 20.00 euro.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja me datën 07.03.2017 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit E. B. nga fshati L. K. P. për rimbursim dëmi, duke theksuar se i padituri me datë 21.01.2011, rreth orës 21:50 në P. ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin e tij ..., me targa të Regjistrimit Deri tek aksidenti ka ardhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte i padituri E. B. i cili nga pakujdesia i shkakton dëm të dëmtuarit G. M. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë pa mbulesë siguruese - respektivisht me afat të skaduar të polices së sigurimit.

Si rezultat i këtij aksidenti të shkaktuar nga i padituri paditësja e ka kompensuar palën e dëmtuar G. M. sipas dispozitave të Rregullit 3 të BQK-së tani dhe LSDA nr.04/L-018 2011 dhe në pajtim

me dispozitat e LMD-së i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1978, i ka kompensuar dëmin jomaterial dhe material të pësuar si rezultat të këtij aksidenti me ujudi jashtëgjqësore ..., të dt., dhe urdhër transferi i dt..... Padiësja në procedurën jashtëgjqësore ka tentuar që me të paditurin ta zgjidhin këtë çështje por nuk ka arritur ta bëjë këtë dhe ta bind atë të përmbush dëmin. Prandaj kërkon nga gjykata që ta detyroj palën e paditur t'ia bëjë rimbursimin e dëmit në shumën prej 529.00 euro, me kamatë si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të LPK – së nr.03/L-006 i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.38/2008 te dt.20.09.2008, i ka dërguar të paditurit padinë, provat materiale dhe Aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi.

Duke e bërë shikimin në fletë dërgesën konstatohet se i padituri e ka pranuar Aktvendimin C.nr.100/17 të dt.13.11.2020, përgjigjen në padi, padinë dhe provat materiale dhe e ka pranuar me dt.17.11.2020, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK-së të lartë cituar. Gjykata mori Aktgjkim për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç vijojnë më poshtë:

- a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja – Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi,
- b) Themelësia e kërkesëpadisë rezulton nga faktet e treguara në padi dhe
- c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë padiësja.

Andaj në kuptim të nenit 160.6 të LPK – së janë dhënë vetëm arsyet që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjkimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mor konform nenit 450 të LPK-së me ç ‘rast secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, pasi që me kohë ato i ka paguar pala paditëse për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 euro.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjkimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË –DEGA PODUJEVË,
Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.100/2017, datë 09.03.2021

Gjyqtari,
Binak Duqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjkimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjkimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.